



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr. 56, datë 24.02.2020

**PËR**

**KRYERJEN E VERIFIKIMIT TË FIGURËS DHE PASURISË  
PËR KANCELARËT NË DETYRË**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 149/a, pika 1, gërma “e”, të Kushtetutës, në nenet 70 dhe 111, të Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenet 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale:

**VENDOSI:**

1. Të kryejë verifikimin e figures dhe pasurisë për kancelarët në detyrë.
2. Të hartojë raporte të veçanta me rezultatet e deklaratave të pasurisë si dhe të vlerësimit të figurës për çdo kancelar në detyrë.
3. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore për kryerjen e këtij procesi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KRYETAR**

**GENT IBRAHIMI**

